



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATURA E SHTETIT  
ZYRA E AVOKATIT TË PËRGJITHSHËM TË SHTETIT

Nr. 1107 prot.

Tiranë, më 26.03.2019

URDHËR

Nr. 60, datë 26.03.2019

“PËR  
MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR PROCEDURAT E ORGANIZIMIT DHE  
ZHVILLIMIT TË PROCESIT TË REKRUTIMIT, PRANIMIT, PERIUdhËS SË  
PROVËS DHE EMËRIMIT TË KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E AVOKATIT TË  
SHTETIT GJATË REGJIMIT LIGJOR KALIMTAR”

Në mbështetje të nenit 6 të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, “Për Avokaturën e Shtetit”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e Rregullores “Për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij urdhri.
2. Ngarkohet Zyra e Protokollit pranë Avokaturës së Shtetit për njoftimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

AVOKAT I PËRGJITHSHËM I SHTETIT

Artur Metani





---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATURA E SHTETIT

## **RREGULLORE**

**“PËR  
PROCEDURAT E ORGANIZIMIT DHE ZHVILLIMIT TË  
PROCESIT TË REKRUTIMIT, PRANIMIT, PERIUDHËS SË  
PROVËS DHE EMËRIMIT TË KANDIDATËVE PËR  
POZICIONIN E AVOKATIT TË SHTETIT GJATË REGJIMIT  
LIGJOR KALIMTAR”**

Miraturar me Urdhrin Nr.60, datë 26.03.2019, të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit

## **KREU I**

### **DISPOZITA TË PËRGJITHSHME**

#### **Neni 1**

##### **Objekti**

Kjo Rregullore përcakton rregulla për procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar.

#### **Neni 2**

##### **Fusha e zbatimit**

Kjo rregullore zbatohet për të gjithë kandidatët të cilët do t'i nënshtrohen procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe marrjes së titullit "Avokat Shteti" në të dy nivelet, në nivel qendror dhe vendor, gjatë regjimit ligjor kalimtar.

#### **Neni 3**

##### **Baza ligjore**

Rregullorja "Për procedurat e organizimit dhe fazat e zhvillimit të vlerësimit profesional të punonjësve të emëruar përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit", bazohet në shkronjën "c", pika 4, të nenit 28, të ligjit nr. 86/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit".

## **KREU II**

### **REKRUTIMI, PRANIMI, PERIUDHA E PROVËS DHE EMËRIMI I KANDIDATËVE PËR POZICIONIN E AVOKATIT TË SHTETIT GJATË REGJIMIT LIGJOR KALIMTAR**

#### **Neni 4**

##### **Regjimi ligjor kalimtar**

1. Përgjithësisht, deri në daljen e grupit të parë të kandidatëve për avokat shteti, të cilët kanë përfunduar programin e formimit fillestar pranë Shkollës së Magjistraturës, apo kur prurjet nga Shkolla e Magjistraturës nuk janë të mjaftueshme për të plotësuar kërkesat e Avokaturës së Shtetit, por jo më vonë se 5 vjet nga hyrja në fuqi e ligjit nr. 86/2018 "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", në mungesë të kandidatëve që plotësojnë kushtin e parashikuar në pikën 1, shkronja "c", të nenit 20, të ligjit nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit" i ndryshuar, në pozicionin e avokatit të shtetit mund të emërohet edhe kandidati, i cili plotëson kushtet e mëposhtme:

- a) të jetë shtetas shqiptar;
- b) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c) ka përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo ka përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;
- ç) të mos jetë i dënues me vendim gjykatë të formës së prerë, për kryerjen e një vepre penale;

d) të mos jetë shkarkuar nga shërbimi civil, apo çdo funksion tjetër publik, për shkelje ose paafësi në kryerjen e detyrave;

dh) të gëzojë integritet moral dhe profesional;

e) ka jo më pak se 6 vite përvojë pune në sistemin gjyqësor ose në administratën publike, brenda profilit të detyrës së avokatit të shtetit;

ë) kalon me sukses procesin e përzgjedhjes, të organizuar nga Avokatura e Shtetit sipas rregullave dhe procedurave të përcaktuara në këtë Rregullore.

2. Përfshihen nga parashikimi i shkronjës “ë”, të pikës 1, të këtij neni, kandidatët që përmbushin njërin prej kushteve të mëposhtme:

a) kanë punuar gjyqtar ose prokuror;

b) zotërojnë eksperiencë pune si jurist prej jo më pak se 10 vjet përvojë profesionale në administratën e Kuvendit, Presidentit, aparatit e Këshillit të Ministrave, ministri dhe institucione qendrore të pavarura, në Gjykatën Kushtetuese dhe Gjykatën e Lartë;

c) zotërojnë eksperiencë pune, si dhe integritet profesional si pedagog pranë Fakultetit të Drejtësisë apo Shkollës së Magjistraturës.

## **Neni 5**

### **Sistemi i përzgjedhjes së kandidatëve**

1. Bazuar në planifikimin vjetor të pranimit të kandidatëve në pozicionin e avokatit të shtetit, ose gjatë vitit, kur shfaqet e nevojshme si rezultat i krijimit të vendeve vakante në mënyrë të paparashikuar, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit njofton hapjen e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve.

2. Procesi i përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit, kryhet në çdo rast me anë të sistemit të konkurrimit (testimit dhe vlerësimit profesional), në të cilin kanë të drejtë të marrin pjesë të gjithë kandidatët që plotësojnë kushtet ligjore, sipas parashikimeve të nenit 4, të kësaj Rregullore.

3. Procesi i përzgjedhjes përbëhet nga 4 (katër) faza të njëpasnjëshme:

a) Kualifikimi;

b) Provimi fillestar;

c) Periudha e formimit;

ç) Konfirmimi në detyrë.

4. Për organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, për përgatitjen e programit, apo materialeve të testimit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund të kërkojë asistencë teknike të nevojshme nga Shkolla e Magjistraturës, Fakulteti i Drejtësisë, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA), ente apo institucione akademike ose profesionale të njohura në fushën e së drejtës, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

## **Neni 6**

### **Shpallja e procedurës së përzgjedhjes**

1. Informacioni në lidhje me formën e kërkesës, regjistrimin, shpalljen e listës së kandidatëve, afateve, programin, si dhe çështje të tjera që lidhen me organizimin dhe zhvillimin e procesit të përzgjedhjes së kandidatëve, publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokaturës së Shtetit.

2. Shpallja e procedurës së përzgjedhjes publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokaturës së Shtetit dhe përmban:

a) Programin e konkurrimit, aftësitë dhe cilësitë që do të vlerësohen në konkurrim;

b) Fazat në të cilën do të kalojë procesi i përzgjedhjes;

c) Numrin e vendeve të planifikuara, për të cilat do të behet pranimi;

ç) Kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta në përputhje me nenin 4, të kësaj Rregullore;

d) Përshkrimin e përgjithshëm të punës për pozicionin e avokatit të shtetit, për të cilin do të zhvillohet konkurrimi;

dh) Dokumentet që duhet të dorëzohen dhe mënyrën e dorëzimit të tyre;

ë) Afatin e dorëzimit të përcaktuar me datë të saktë kalendarike;

f) Datën e publikimit të rezultateve për fazën e kualifikimit të kandidatëve;

g) Datën, vendin, orën dhe fazat e zhvillimit të provimi fillestar;

gj) Mënyrën e vlerësimit të kandidatëve pjesëmarrës në provimin fillestar;

h) Datën e publikimit së rezultateve të konkurrimit;

i) Mënyrën e njoftimit dhe komunikimit me kandidatët.

## **Neni 7**

### **Paraqitja e kërkesës dhe dokumentacionit**

1. Kandidati i interesuar paraqet një kërkesë me shkrim drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit për t'u pranuar në procesin e përzgjedhjes. Kërkesa plotësohet sipas modelit të miratuar nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, model i shpallur njëkohësisht me njoftimet, programin dhe informacionin mbi procesin përzgjedhës.

2. Kandidati i interesuar së bashku me kërkesën paraqet kopje të dokumenteve që vërtetojnë plotësimin e kërkesave ligjore, meritat, si dhe përvojën akademike dhe profesionale të kërkuar.

3. Kërkesa dhe dokumentacioni shoqëruet depozitohen në afatin dhe vendin e përcaktuar jo më vonë se 20 (njëzet) ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes për procesin e përzgjedhjes.

4. Në rast të mosplotësimit në formën e duhur të kërkesës, apo/dhe mangësi në dokumentacionin e kërkuar, vendoset mospranimi i përkohshëm i aplikimit të kandidatit në procedurën përzgjedhëse. Mospranimi sipas kësaj pike do të jetë i përkohshëm, me kusht që të plotësohen nga kandidati brenda një afati të caktuar nga dita e njoftimit mangësitë e konstatuara. Në rast se brenda këtij afati, mangësitë ose defektet formale nuk janë plotësuar, vendoset mospranimi përfundimtar i kandidatit.

5. Kandidatëve mund t'u kërkohej në çdo fazë të procesit përzgjedhës që të paraqesin brenda një afati të caktuar dokumente origjinale dhe vërtetime të besueshme të meritave, përvojës akademike ose profesionale të kërkuar dhe të paraqitur në kërkesën e tyre. Në rast të mosplotësimit të këtij detyrimi në afatin e përcaktuar, ose nëse në cilëndo fazë të procesit përzgjedhës, do të konstatohet që kandidati nuk i përmbush kërkesat ligjore ose ato të parashikuara në njoftimin për shpalljen e procesit përzgjedhës, ata do të përjashtohen nga pjesëmarrja në procedurat vijuese.

## **Neni 8**

### **Kualifikimit i kandidatëve**

1. Për organizimin dhe zhvillimin e procesit të kualifikimit të kandidatëve me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ngrihet Komisioni i Kualifikimit të Kandidatëve (Komisioni i Kualifikimit).

2. Komisioni i Kualifikimit përbëhet nga pesë anëtarë, një prej të cilëve është kryetari. Komisioni i Kualifikimit përbëhet nga 3 avokat shteti pranë Institucionit të Avokaturës së Shtetit.

3. Komisioni i Kualifikimit në bazë të dokumentacionit të paraqitur, jo më vonë se 5 (pesë) ditë pune nga data e mbylljes së pranimit të tyre, bën verifikimin e dokumentacionit të paraqitur nga ana e kandidatëve, që përmbushin kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, të përcaktuara në shpalljen për konkurrim.

4. Në përfundim të verifikimit, kandidatët, të cilët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta, renditen në një listë sipas rendit alfabetik. Lista e kandidatëve të kualifikuar publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokaturës së Shtetit.

5. Kandidatët, të cilët nuk plotësojnë kërkesat e përcaktuara në shpalljen për konkurrim, renditen në një listë të veçantë, në të cilën tregohen edhe arsyet e mosplotësimit të kërkesave. Lista administrohet nga institucioni i Avokaturës së Shtetit dhe nuk bëhet publike. Kandidatët që nuk janë kualifikuar njoftohen individualisht.

6. Kundër vendimeve të dhëna sipas këtij neni, kandidati i interesuar mund të paraqesë ankim administrativ, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, brenda 24 orëve nga shpallja e listës së kandidatëve të pranuar ose jo. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit vendos lidhur me ankimin brenda 7 ditëve nga depozitimi i tij.

## **Neni 9**

### **Provimi fillestar**

1. Kandidati i kualifikuar i cili plotëson kushtet ligjore për t'u emëruar në pozicionin e avokatit të shteti ka të drejtë të marrin pjesë në provimin fillestar. Provimi fillestar, trajton çështje teorike dhe praktike, si dhe zhvillohet në dy faza:

- a) testim me shkrim; dhe
- b) intervistë e strukturuar me gojë.

2. Programi i provimit fillestar miratohet paraprakisht nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit dhe përmban tema të të drejtës kushtetuese, të drejtës civile, të drejtës penale, procedurës civile, procedurës penale, të drejtës administrative, të drejtës së punës, të drejtës tregtare, të drejtës publike, apo fusha të tjera të të drejtës, me të cilat lidhet veprimtaria e Avokaturës së Shtetit.

3. Testimi me shkrim realizohet me teza testimi dhe përbëhet nga raste nga praktika gjyqësore/administrative, si dhe pyetje teorike të përbashkëta për të gjithë kandidatët, të bazuara në programin e miratuar paraprakisht nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit sipas pikës 2, të këtij neni.

4. Intervista e strukturuar me gojë referohet në jetëshkrim, si dhe në pyetje të cilat i japin mundësi Komisionit të Vlerësimit të Provimit Fillestar të vlerësojnë motivimin, aftësitë profesionale, të komunikimit dhe personalitetin e kandidatit.

5. Për organizimin dhe zhvillimin e procesit, për përgatitjen e programit, apo materialeve të testimit, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit mund të kërkojë asistencë teknike të nevojshme nga Shkolla e Magjistraturës, Fakulteti i Drejtësisë, Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), ente apo institucione akademike, ose profesionale të njohura në fushën e së drejtës, në nivel kombëtar ose ndërkombëtar.

## **Neni 10**

### **Komisioni i Vlerësimit të Provimit Fillestar**

1. Për organizimin dhe zhvillimin e provimit fillestar me urdhër të Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit ngrihet Komisioni i Vlerësimit të Provimit Fillestar (Komisioni i Vlerësimit).

2. Komisioni i Vlerësimit përbëhet nga pesë anëtarë, një prej të cilëve është kryetari. Anëtarë të Komisionit mund të caktohen magjistratë, avokat shteti, përfaqësues të Shkollës së Magjistraturës, Fakultetit të Drejtësisë, përfaqësues nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASP), apo funksionarë të administratës publike, të cilët janë juristë me aftësi të spikatura profesionale.

3. Komisioni i Vlerësimit mund të asistohet gjithashtu nga vëzhgues të pavarur për të garantuar transparencën dhe korrektesën e procesit të vlerësimit.

4. Në kuadër të organizimit dhe zhvillimit të provimit fillestar Komisioni i Vlerësimit ushtron këto detyra:

- a) Harton dhe miraton strukturën e tezës së testimit me shkrim në përputhje me formatin e bazuar në këtë Rregullore, si dhe programin e miratuar paraprakisht nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit sipas pikës 2, të nenit 9, të kësaj Rregullore;



b) Harton dhe miraton strukturën, përmbajtjen dhe mënyrën e vlerësimit të pyetjeve të intervistës me gojë;

c) Kryen korrigjimin e testimin me shkrim dhe vlerësimin e intervistës me gojë;

ç) Plotëson procesverbalet dhe dokumentacionin e vlerësimit të testimin me shkrim, si dhe intervistës me gojë dhe e vë në dispozicion të administratorit për shpalljen e rezultateve.

## **Neni 11**

### **Masat administrative për kryerjen e provimit fillestar**

1. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit për organizimin dhe zhvillimin e provimit fillestar vë në dispozicion të Komisionit të Vlerësimit personelin e nevojshëm njerëzor, njëri prej të cilëve kryen edhe detyrën e administratorit, si dhe ofron çdo lloj asistence teknike dhe materiale të nevojshme për zhvillimin me korrektësi të provimit.

2. Administrimi i procesit të provimit kryhet nga administratori i cili:

a) organizon dhe ndjek punën për përgatitjen e përmbajtjes së procesit të provimit fillestar;

b) organizon dhe ndjek punën për sigurimin e bazës materiale dhe shumëfishimin e materialeve të shkruara si për testimin me shkrim ashtu edhe për intervistën me gojë;

c) organizon dhe ndjek punën për përgatitjen e mjediseve për zhvillimin e procesit të provimit;

ç) udhëzon mbi mënyrën e procedimit gjatë zhvillimit të procesit të provimit;

d) mbikëqyr zhvillimin, si dhe respektimin e orarit të testimin me shkrim dhe intervistës me gojë;

dh) merr masa për të ndaluar hyrjen e personave të paautorizuar në mjediset ku zhvillohen procesi i vlerësimit kalimtar;

e) njofton dhe raporton pranë Komisionit për çdo parregullsi, si dhe për masat që janë marrë për zhvillimin e procesit të vlerësimit kalimtar;

ë) kryen veprimet përmbysë të administrimit të materialeve të provimit;

f) shpall rezultatet e procesit të vlerësimit;

g) kryen çdo detyrë tjetër me karakter administrativ në kuadër të procesit të vlerësimit kalimtar.

## **Neni 12**

### **Hartimi i testimin me shkrim**

1. Komisioni i Vlerësimit harton dhe miraton paraprakisht strukturën e tezës së testimin me shkrim në përputhje me formatin e miratuar të tezës bazuar në këtë Rregullore.

2. Testi me shkrim përmban pjesën teorike nga fushat e së drejtës të parashikuara në programin e provimit dhe pjesën praktike me tre raste nga praktika gjyqësore/administrative. Teza e testimin strukturohet në 6 rubrika dhe vlerësohet maksimalisht me 400 pikë, nga të cilat me 250 pikë vlerësohet pjesa teorike, e cila ndahet: (i) 50 pikë për pjesën teorike të së drejtës civile, procedurës civile, të drejtës së punës, drejtës tregtare; (ii) 50 pikë për pjesën teorike të drejtës penale dhe procedurës penale; (iii) 50 pikë për pjesën teorike të drejtës administrative dhe të procedurës administrative; (iv) 50 pikë për pjesën teorike si e drejta kushtetuese, etika profesionale, apo administrata publike; si dhe (v) 50 pikë për pjesën teorike të së drejtës, me të cilat lidhet veprimtaria e Avokaturës së Shtetit. Pjesa e rasteve praktike vlerësohet me 150 pikë, nga 50 pikë për secilin rast praktik.

3. Hartimi dhe zgjedhja e pyetjeve për testimin me shkrim bëhet 24 (njëzetekatër) orë para ditës së testimin nga Komisioni për çdo përbërës të disiplinës në proporcion me përqindjen që ato duhet të zënë në test duke siguruar një tezë cilësore dhe profesionale dhe një shpërndarje të drejtë të natyrës së pyetjeve sipas strukturës së miratuar.

4. Menjëherë pas zgjedhjes së pyetjeve, hartohet testi, shumëfishohet në ambiente të mbyllura, në aq ekzemplarë sa janë kandidatët e parashikuar për të marrë pjesë në vlerësimin profesional plus 2% më shumë për efekt administrativ.

### **Neni 13** **Organizimi i testimit me shkrim**

1. Testimi me shkrim zhvillohet në të njëjtin ambient për të gjithë kandidatët, si dhe kohëzgjatja e testimit do të jetë jo më pak se 2 (dy) orë. Orari i testimit përcaktohet nga Komisioni në përputhje me përmbajtjen dhe kohën e nevojshme për të zgjidhur tezën dhe u njoftohet kandidatëve në momentin e fillimit të testimit.

2. Kandidatët duhet të paraqiten në ambientet e zhvillimit të provimit me shkrim 30 minuta përpara orarit të fillimit të provimit me qëllim verifikimin e prezencës mbi bazë të dokumentit të identifikimit dhe sistemimin në pozicionin përkatës të provimit.

3. Procedura e testimit garanton barazinë e kandidatëve në vlerësim dhe vlerësimi i tij kryhet nga Komisioni mbi bazë të parimit të ruajtjes së anonimitetit.

4. Gjatë procesit të testimit pjesëmarrësi duhet të ketë me vete vetëm dokumentin e identifikimit. Materialet për zhvillimin e testimit do të vihen në dispozicion nga institucioni në ambientet ku do të zhvillohet testimi.

5. Fletët e përgjigjes së tezës me shkrim do të jenë të gjitha të sekretuara. Të gjithë kandidatëve do t'u shpërndahet një zarf i vogël, i cili brenda ka një letër në të cilën do të shkruhet emri i kandidatit që konkurren. Zarf i vogël nuk duhet të mbyllet deri në momentin e dorëzimit të provimit. Mbyllja e tij do të bëhet në prani të administratorit të provimit, duke u verifikuar edhe njëherë identiteti i kandidatit dhe do të vulozet nga personi përgjegjës i caktuar nga administratori i provimit. Zarf i madh do të mbyllet nga kandidati dhe duhet të ketë brenda tezën e testit. Zarf do të vulozet nga personi përgjegjës. Përmbajtja e çdo zarfi është në përgjegjësinë e kandidatit përkatës.

6. Secili kandidat nënshkruan një deklaratë për njohjen dhe pranimin e rregullave të testimit të vlerësimit profesional.

7. Gjatë provimit, në sallë mund të qëndrojnë persona/grupe vëzhguesish. Vëzhguesit do të jenë persona me profesion të ndryshëm nga ai i juristit. Ata mund të jenë shtetas shqiptarë ose të huaj, nga organizata me të cilat Avokatura e Shtetit ka pasur dhe ka marrëdhënie bashkëpunimi. Në qoftë se vëzhguesit konstatojnë shkelje sado të vogla të rregullave të testimit, ata do t'i kërkojnë administratorit që kandidati të lënë sallën menjëherë.

8. Pjesëmarrësit nuk duhet të komunikojnë me njëri-tjetrin, për asnjë lloj arsyeje. Pjesëmarrësi nuk duhet të asistojë, apo të marrë asistencë nga çdo pjesëmarrës tjetër gjatë testimit. Vëzhguesit janë të detyruar të raportojnë çdo rast të thyerjes së rregullave të testimit dhe nëse pjesëmarrësi dyshohet për thyerje të rregullave të testimit.

9. Pjesëmarrësit nuk i lejohet që të marrë me vete jashtë sallës së provimit testin, apo kopje të testit. Pas shpërndarjes së testit, pjesëmarrësit nuk i lejohet të dalë nga salla e testimit deri në përfundim të kohës së testimit dhe atëherë vetëm pasi vëzhguesit e testimit të kenë mbledhur të gjitha testet dhe zarfet e vegjël nga tavolinat e pjesëmarrësve dhe të japin udhëzimin për tu larguar.

10. Nuk lejohet që kandidati të largohet nga salla e testimit pa dorëzuar më parë tezën e provimit.

11. Gjatë testimit, pjesëmarrësve iu ndalohet të shënojnë emrin, apo të kryejnë çdo lloj shënimi tjetër në fletën e testit. Në rast të një korigjimi, fjala ose shprehja do të futet në kllapa, do t'i kalohet një vijë sipër sipas këtij modeli: (~~gabim~~). Në rast se konstatohen shenja të ndryshme në fletët e testimit, ato do të shpallen të pavlefshme dhe pjesëmarrësi humbet të drejtën për t'u vlerësuar.

12. Ndalohet përdorimi dhe mbajtja e telefonave celularë si dhe e pajisjeve të tjera.



13. Në fund të kohës së provimit një prej vëzhguesve lajmëron se koha e testimit ka përfunduar dhe duke nisur nga ai moment pjesëmarrësit nuk i lejohet të shkruajë si dhe nuk i lejohet të largohet nga tavolina deri sa të udhëzohet nga vëzhguesi i sallës.

14. Në përfundim të testimit të gjitha fletët do të vendosen në një kuti të vulosur. Gjithashtu edhe zarfet e vegjël do të jenë të futura në një kuti të vulosur.

#### **Neni 14**

#### **Intervista e strukturuar me gojë**

1. Intervista e strukturuar me gojë do të zhvillohet në një datë të ndryshme dhe të mëvonshme, nga ajo e testimit me shkrim. Kjo datë i njoftohet pjesëmarrësve nga Komisioni ditën e testimit me shkrim.

2. Qëllimi i zhvillimit të intervistës me gojë është vlerësimi i jetëshkrimit, aftësive profesionale, të komunikimit, logjika e argumentimit të fakteve, prezantimi i tyre në publik, si dhe personaliteti i secilit kandidat. Gjithashtu do të vlerësohen njohuritë dhe aftësitë për argumentim dhe përgjigje nën presionin e kohës.

3. Gjatë zhvillimit të intervistës do të përdoret e njëjta metodologji për të gjithë pjesëmarrësit. Pyetjet që do të përdoren gjatë intervistës me gojë janë standarde për të gjithë kandidatët dhe do të konsistojnë në:

- a) pyetje lidhur me sjelljen;
- b) pyetje lidhur me një situatë hipotetike;
- c) pyetje lidhur me dijet.

4. Pyetjet lidhur me sjelljen përgatiten sipas metodës STAR (situata, detyra, veprimi rezultati), ndërsa pyetjet lidhur me situatën hipotetike hartohen më qëllim për t'i vënë kandidatët në një situatë të lidhur me punën në mënyrë që ata të mund të përshkruajnë sjelljen e tyre të ardhshme. Pyetjet lidhur me dijet kërkojnë që kandidatët të përshkruajnë dijet e tyre, ose kërkojnë që ata t'i tregojnë ato. Gjatë intervistës me gojë nuk bëhen pyetje në lidhje me moshën, gjendjen civile, gjendjen familjare ose planet, preferencat fetare, pikëpamjet politike, apo tjetër të këtij lloji.

5. Brenda pyetjeve të së njëjtës fushë mund të përdoren një sërë pyetjesh të standardizuara, si dhe Komisioni mund të shtrojë një sërë pyetjesh shtesë të bazë të përgjigjeve të dhëna nga kandidati. Komisioni mund të shtrojë pyetje edhe duke u bazuar në përmbajtjen e testimit me shkrim duke i mundësuar kandidatëve të dëshmojnë aftësitë profesionale edhe në intervistën me gojë.

6. Niveli i vlerësimit të pyetjeve të intervistës me gojë do jetë:

- a) “Shumë keq”, kur kandidati nuk arrin t'i përgjigjet fare pyetjes ose nuk e di përgjigjen;
- b) “Keq”, kur përgjigjja e kandidatit për pyetjen është e paplotë, ose e paqartë;
- c) “Kënaqshëm”, kur kandidati i përgjigjet pjesërisht pyetjes, ose përgjigjja e tij/e saj nuk është plotësisht e saktë, por ai / ajo demonstroi një njohuri të mirë të temës dhe të të menduarit logjik;

- ç) “Mirë”, kur kandidati i përgjigjet pyetjes saktë;

- d) “Shumë mirë”, kur kandidati i përgjigjet pyetjes me shumë detaje duke treguar se dijet e tij/saj i tejkalojnë kërkesat.

7. Secili prej anëtarëve të Komisionit vlerëson çdo pyetje me pikë. Intervista e strukturuar me gojë vlerësohet maksimalisht 100 (njëqind) pikë. Formula për llogaritjen e pikëve të intervistës me gojë është: Pikët në total mbledhen dhe pjesëtohen me 5 (pesë), duke i rumbullakosur deri në një presje dhjetore.

8. Procesverbali i vlerësimit të pjesëmarrësve hartohet me shkrim dhe nënshkruhet nga të gjithë anëtarët e Komisionit. Në përfundim të procesit do të shpallet vetëm vlerësimi në total për secilin kandidat.

## Neni 15

### Administrimi i materialeve dhe dokumentacionit

1. Pas përfundimit të provimit administratori dhe vëzhguesit dorëzojnë materialet dhe dokumentacionin te anëtarët e Komisionit të Vlerësimit.
2. Pas dorëzimit të dokumentacionit, Komisioni i Vlerësimit në prani të administratorit dhe vëzhguesve do të vendosë numrin si në zarfin e vogël ashtu dhe në zarfin e madh të çdo kandidati. Komisionit të Vlerësimit do t'i vihet në dispozicion vetëm zarfi i madh, me numrin përkatës, i cili përmban fletët e testit.
3. Kryetari së bashku me anëtarët e tjerë të Komisionit të Vlerësimit dorëzojnë gjithë materialet e testimit në ambientet e Avokaturës së Shtetit.
4. Zarfet e vegjël pas sekretimit mbyllen në kasafortë, si dhe testet depozitohen në një vend tjetër të sigurt (ose kasafortë) në ambientet e Avokaturës së Shtetit.

## Neni 16

### Korrigjimi i testeve dhe vlerësimi i kandidatëve

1. Korrigjimi i testeve me shkrim do të bëhet brenda godinës së Avokaturës së Shtetit.
2. Anëtari i Komisionit të Vlerësimit vlerëson testin me shkrim në mënyrë të pavarur dhe të paanshme duke respektuar anonimatën e kandidatit. Secili anëtar vlerëson rubrikën përkatëse të testit për të cilën është përgjegjës.
3. Anëtari i Komisionit të Vlerësimit nuk lejohet që të marrë me vete testet, apo kopje të çfarëdolloj të testit (elektronike, në letër, skanim, apo çdo lloj forme tjetër riprodhimi të materialeve).
4. Gjatë procesit të korrigjimit, në ambientet ku zhvillohet korrigjimi, lejohet të qëndrojnë vetëm anëtarët e Komisionit të Vlerësimit.
5. Kur anëtari i Komisionit të Vlerësimit ndërpret korrigjimin, një anëtar tjetër i caktuar nga kryetari i thirret për t'i marrë testet në dorëzim. Ky vlerësim vendoset menjëherë në vend të sigurt dhe rimerret vetëm nga i njëjti anëtar kur nis përsëri procesi i korrigjimit. Në përfundim të korrigjimit, anëtari dorëzon vlerësimet e tij në formë të shkruar dhe të nënshkruar prej tij.
6. Në përfundim të procesit të korrigjimit, secili anëtar i Komisionit të Vlerësimit dorëzon listën e pikëve (në formë të shkruar dhe të nënshkruar prej tyre) për secilën seksion të korrigjuar, sipas numrit të sekretimit të testit, në formë tabelore ku paraqitet numri i sekretimit të çdo testi dhe pikët përkatëse për secilin rubrikë, sipas pjesës së caktuar për korrigjim.
7. Hapja e zarfeve të vegjël dhe përlllogaritja e rezultateve të secilit kandidat, duke bashkuar emrin me numrin e sekretimit të tij, pikëve të fituara në testimin me shkrim dhe intervistën me gojë, bëhet në prani të të gjithë anëtarëve të Komisionit të Vlerësimit, si dhe administratorit të provimit.
8. Rezultatet përfundimtare llogariten mbi bazën e pikëve të arritura në testin me shkrim dhe intervistën me gojë. Kandidatët renditen, sipas rezultateve më të larta të pikëve, në rend zbritës, deri në plotësimin e numrit të pozicioneve të lira për secilën njësi organizative, për të cilën kanë konkurruar, por pa zbritur te kandidatët që kanë marrë më pak se 60 % (për qind) të totalit të pikëve maksimale të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë.
9. Kandidati i cili ka marrë mbi 60 % (për qind) të totalit të pikëve maksimale të testimit me shkrim dhe intervistës me gojë, por nuk rezulton fitues për shkak të plotësimit të pozicioneve të lira për secilën njësi organizative regjistrohet në listë pritje për vendin e parë të lirë të të njëjtit pozicion me atë për të cilin ka konkurruar. Secili kandidat nënshkruan një deklaratë personale ku deklaron njësinë organizative për të cilën konkurron, si dhe pranimin për t'u regjistruar në listën e pritjes;
10. Komisioni i Vlerësimit harton procesverbalin përfundimtar të vlerësimit të kandidatëve dhe e vë në dispozicion të administratorit për shpalljen e rezultatit.

## **Neni 17**

### **Shpallja e rezultatit të vlerësimit**

1. Rezultati i vlerësimit shpallet jo më vonë se 7 (shtatë) ditë pune pas përfundimit të testimit me shkrim.

2. Lista e kandidatëve publikohet në faqet e internetit të Avokaturës së Shtetit. Njoftimi përmban emrin, mbiemrin, pozicionin dhe zyrën për të cilën ka aplikuar dhe numrin e pikëve të arritura nga kandidati në testin me shkrim dhe intervistën me gojë.

3. Çdo kandidat lajmërohet dhe individualisht, në mënyrë elektronike ose me postë, për totalin e pikëve të fituara.

## **Neni 18**

### **E drejta e ankimit lidhur provimin fillestar**

1. Kandidati i interesuar mund të paraqesë ankim administrativ me shkrim, drejtuar Avokatit të Përgjithshëm të Shtetit, brenda dy ditëve pune nga shpallja e rezultateve përfundimtare të vlerësimit të kandidatëve.

2. Kandidati ka të drejtë të ankohet vetëm për procedurën e kryerjes së testimit, apo intervistës me gojë, apo për gabime të natyrës matematikore të pikësimit të kandidatit dhe jo për natyrën e vlerësimit që është bërë nga Komisioni i Vlerësimit.

3. Avokati i Përgjithshëm i shtetit vendos lidhur me ankimin brenda 10 (dhjetë) ditëve nga depozitimi i tij.

## **Neni 19**

### **Lista e pritjes**

1. Pas përfundimit të procedurave të ankimit, kandidati i cili në zbatim të pikës 9, të nenit 16, të kësaj Rregullore ka nënshkruar deklaratën personale të pranimit për t'u regjistruar në listën e pritjes, listohet në listë mbi bazë të numërit rendor të kualifikimit dhe njoftohet elektronikisht.

2. Lista e pritjes administrohet nga Avokatura e Shtetit për një periudhë kohore prej 6 muaj dhe kur brenda këtij afati rezultojnë një vend i lirë brenda të njëjtës njësi organizative për të cilin kandidati ka konkurruar, ai emërohet sipas nenit 20, të kësaj Rregullore;

3. Avokatura e Shtetit nuk ka asnjë detyrim në lidhje me kandidatin në listë pritje nëse nuk do të krijohen pozicione vakante pranë institucionit brenda afatit të përcaktuar në pikën 2, të këtij neni, ose nëse pas propozimit ky i fundit nuk e pranon pozicionin e punës.

## **Neni 20**

### **Emërimi i përkohshëm i kandidatëve**

Kandidati që kalon me sukses provimin fillestar emërohet përkohësisht në pozicionin e avokatit të shtetit nga Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

## **Neni 21**

### **Periudha e formimit**

1. Kandidati që shpallet fitues për pozicionin e avokatit të shtetit i nënshtrohet një periudhe formimi që zgjat një 6 muaj nga data e aktit të emërimit. Gjatë periudhës së formimit, kandidati përfiton të njëjtin trajtim si avokati i shtetit në detyrë.

2. Gjatë periudhës së formimit kandidati është i detyruar të ndjekë:

a) programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e formimit pranë Avokaturës së Shtetit;

b) udhëzimet e një avokati më të vjetër shteti, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur.

3. Avokati më i vjetër i shtetit përzgjidhet avokati, i cili ka vjetërsinë më të madhe në detyrë dhe që bën pjesë në të njëjtën njësi organizative, ku është emëruar avokati në periudhë formimi.

4. Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, në rast largimi, apo pamundësie të ushtrimit të detyrës nga avokati i shtetit më i vjetër në detyrë, merr masa për zëvendësimin e tij me avokatin e shtetit të dytë më të vjetër në detyrë brenda së njëjtës njësi organizative.

5. Në rast se gjatë periudhës së formimit Avokati i Përgjithshëm i Shtetit apo avokati më i vjetër largohet nga ai pozicion pune, apo ndodhet në pamundësi të vazhdimin të mëtejshëm të detyrës, ai është i detyruar të bëjë një vlerësim paraprak për avokatin në periudhë formimi. Vlerësimi paraprak merret si bazë nga avokati zëvendësues në vlerësimin e tij përfundimtar.

6. Vendimi në përfundim të periudhës së formimit merret bazuar në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, i cili kryhet sipas procedurave të përcaktuara në nenin 25, në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

## **Neni 22**

### **Konfirmimi në detyrë**

1. Bazuar në vlerësimet sipas pikës 6, të nenit 21, të kësaj Rregullore dhe pas marrjes së mendimit me shkrim nga avokati i shtetit më i vjetër, Avokati i Përgjithshëm i Shtetit, vendosë:

a) konfirmimin në detyrë të kandidatit dhe emërimin në pozicionin e avokatit të shtetit, si dhe marrjen e titullit në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

b) zgjatjen një herë të vetme deri në 6 (gjashtë) muaj të periudhës së formimit, në rast të:

i) nevojës për një periudhë prove më të gjatë për shkak të kompleksitetit të vendit të punës;

ii) pamundësisë së vlerësimit të plotë të avokatit, në rastet e mungesës në detyrë të tij për shkak të trajnimit afatgjatë, raportit mjekësor afatgjatë dhe në raste të tjera, të parashikuara nga legjislacioni në fuqi, të cilat rregullojnë mungesën në detyrë të avokatit të shtetit;

c) moskonfirmimin e kandidatit në detyrë dhe mos emërimin e tij në pozicionin e avokatit të shtetit në përputhje me kushtet, kriteret dhe procedurat e parashikuara në ligjin nr. 10018, datë 13.11.2008, "Për Avokaturën e Shtetit", i ndryshuar.

## **Neni 23**

### **Arkivimi i dokumentacionit**

Dokumentacioni i procesit të përzgjedhjes së kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit arkivohet dhe ruhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për arkivat.

## **KREU III**

### **DISPOZITA TË FUNDIT**

## **Neni 24**

### **Parashikime të fundit**

Çdo akt nënligjor në formën e urdhrit, apo të udhëzimit që rregullon çështjet, procedurat e organizimit dhe zhvillimit të procesit të rekrutimit, pranimit, periudhës së provës dhe emërimit të kandidatëve për pozicionin e avokatit të shtetit gjatë regjimit ligjor kalimtar dhe që bie ndesh me këtë rregullore, shfuqizohet.



**Neni 25**  
**Hyrja në fuqi**

Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të institucionit të Avokaturës së Shtetit

**AVOKATI I PËRGJITHSHËM I SHTETIT**

**Artur Metani**

